




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 224/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërjez. Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi- Referues, z. Blerim Dina- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Proinfo ICT" SH.P.K.- Prishtinë, kundër njoftimi për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Implementimi i sistemit të menaxhimit elektrik të automjeteve me pajisje GPS", me numër të prokurimit: 616-19-2881-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, më datën 25.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Proinfo ICT" SH.P.K.- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Implementimi i sistemit të menaxhimit elektrik të automjeteve me pajisje GPS", me numër të prokurimit: 616-19-2881-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues /Komuna e Prishtinës / ti bëjë ndryshimet në dosje të tenderit, konform konstatimeve të ekspertit teknik dhe të veprave konform nenit 53.7 të LPP-së, lidhur me aktivitetin të prokurimit "Implementimi i sistemit të menaxhimit elektrik të automjeteve me pajisje GPS", me numër të prokurimit: 616-19-2881-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Proinfo ICT" SH.P.K.-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:09.05.2019

Afati i fundit për sqarime shtese me dt:23.05.2019

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt: 31.05.2019

Kërkesa për rishqyrtim me dt: 13.05.2019

Autoriteti Kontraktues me brenda afatit ligjor ka marrë vendim duke e refuzuar kërkesën për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues "Proinfo ICT" SH.P.K.-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 20.05.2019 me nr. 224/19, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Implementimi i sistemit të menaxhimit elektrik të automjeteve me pajisje GPS", me numër të prokurimit: 616-19-2881-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me paragrafët 2, 4, 7 të nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 07.06.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:18.06.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:**Sqarim:**Duke u bazuar në dosjen e tenderit, specifikave teknike si : “Vërejtje: Komuna posedon pajisjet e lartë cekura, dhe nuk ka ndërmend që të bëjë ndryshime të pajisjeve, andaj OE fitues duhet të mirëmbajë pajisjet ekzistuese. OE fitues duhet të përfshijë sim kartelën me GPRS në çmim.“Bazuar edhe në pyetjet dhe përgjigjet e adresuara për këtë aktivitet të prokurimit.

AK ka bërë shkelje të nenit 28 duke përgatitur Specifika të cilat kufizojnë tregun pavarësisht se në stok ka produkte të caktuara, andaj konsideroj se nëse AK vazhdon me procedure të hapur të prokurimit do të duhet të u jap mundësi të gjithë OE të aplikojnë për një Projekt të tillë.

Konsideroj se nëse AK dëshiron që të ketë treg të hapur dhe oferta për këtë produkte atëherë AK mund të kërkojë nga OE që në ofertat e tyre të ofrojnë produktet e tyre të cilat plotësojnë specifika minimale të kërkuara nga AK-ja dhe të mund të zëvendësojë të gjitha pajisjet me produktet e tyre pa Kosto Shtese ose nëse oferton me produktet e njëjtat të vazhdojë mirëmbajtjen e tyre.

Ne lidhje me pretendimin: Kërkesa që produkti të ketë standardin: **GLONASS**,

Sqarim: Konsideroj se AK mund të kërkojë Standardë në mënyrë që të kërkojë edhe kualitet më të mirë të produktit pa cenuar Tregun, kjo nënkupton se AK mund të kërkojë një Standard të Tille si **GLONASS** mirëpo konsideroj se duhet të shtohet edhe një fjali e cila potencon se OE mund të ofrojnë edhe Standarde Ekuivalente, pasi kërkimi i vetëm një standardi kufizon tregun.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe OE të krijojë Terma të referencës të cilët do të Hapin mundësinë e ofertimit edhe prodhuesëve të tjerë.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 18.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim brenda afatit ligjor nuk ka kthyer përgjigje për ta njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet apo nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë

kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtrësit e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Çeladeklaroj: Ne përfaqësojmë kompaninë, jemi përfaqësues të Kompanisë Arvento, ne siç kemi cek ne ankesë dhe kërkesë për rishqyrtim, kemi bërë kërkesë që të na lejohet qasja të marrim pjesë në këtë proces të tenderimit ku mendojmë që janë shkellet 28. Pika 2 pika 7 dhe 4.

Autoriteti Kontraktues ka kontratë me një kompani që ne nuk e njohim që kanë kërkuar autorizim të prodhuesit për pajisje të caktuara dhe staf të certifikuar për pajisje të njëjta për shkak që ne si OE nuk mundemi të marrim pjesë dhe nuk mundemi të ofrojmë ato pajisje që ata kërkojnë, vlen të theksojmë që pajisja GPS është e vogël që vendoset në veturë dhe është e paqashme nga çfarëdo zyrtari pajisje që qon dy informata, këto 2 informata pastaj është softueri që i bënë kërkesat e një kompanie, Autoriteti Kontraktues ka qit specifikime dhe ka kërkuar pajisje ekzistuese të cilat i ka një kompani që Autoriteti Kontraktues e din dhe ka kërkuar staf dhe autorizim për ato pajisje që nuk ka dhënë se çfarë prodhuesi është, dhe sistemi jonë nuk komunikojnë me pajisje të tyre. Kjo praktikë i bie ne, e as të tjerët përjetësisht ajo kompani ka me ofruar shërbime të njëjta edhe nuk ka konkurrencë të lirë dhe buxheti mund të caktohet sipas dëshirës.

Pajtohemi me mendimin e ekspertit. Kërkojmë që të kemi konkurrencë të gjithë OE-të, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar standardin që përdoret për regjion të Rusisë, ndërsa ne kërkojmë të ofrojmë me standard të EU-së me Galileu.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Marollideklaroj: Desha me të dije në vitin 2016 ne nuk kemi përzgjedhë, ne kemi vepruar sipas ofertës me të lirë dhe kërkesës së komunës, ne nuk e kemi favorizuar por ju kemi përshtat kërkesat të Autoriteti Kontraktues kështu që pajisjet ekzistuese janë blerë nga Autoriteti Kontraktues dhe ekzistojnë në veturë ku kemi edhe 7 ndërmarrje të tjera, ne nuk kemi kërkuar të blejmë prapë por vetëm të bëjmë mirëmbajtjen e tyre, edhe softueri i cili komunikojnë me pajisje ju ka përshtatur softuerit përveç atyre edhe raportimi që është bërë deri tash dhe kompanisë në fjalë askush nuk ja mohon të marrë pjesë, ne nuk mundemi të ia përshtat secilës kompani siç dëshirojmë ne, përshembull: disa pajisje teknologjike nëse pretendojmë që 3 vite më blerë të herë kostoja do të jetë e lartë, kompani ka bërë pyetje citoj "ne përfaqësojmë një kompani që operon në 3 kontinente që bënë prodhimin softuerin dhe harduerin dhe sistemin e juaj, komunikojnë vetëm me pajisjet e prodhuesit të tyre, që i bie pas 3 vite të lindë një problem".

Gjatë prezantimit në seance Eksperti shqyrtues-teknik z. Hisenaj deklaroj: Qëndroj mbrapa raportit të ekspertizës perfektin që Autoriteti Kontraktues ka iniciuar një procedurë të prokurimit të hapur në të cilën do të thotë ka kufizuar tregun për faktin se ka kërkuar që në kuadër të kësaj procedure nuk mund të pranojë asnjë pajisje tjetër përveç pajisjeve që i ka në stok, me çka konsideroj ashtu siç e kam potencuar në raport është në rregull që të kërkojë Autoriteti Kontraktues të vazhdojë me pajisjet që ka në posedim mirëpo duhet të ju mundësojë edhe prodhuesve tjetër nëse i plotësojnë kriteret teknike të zëvendësojnë apo të vazhdojnë me këtë produkt. Nga praktika me institucionin e tjetër ka pasur procedura të tilla, në të kundërtën Autoriteti Kontraktues duhet ta gjejë një model tjetër të prokurimit dhe jo të shkojë me procedure të hapur. Në lidhje me standardin kërkohet të vendoset një standard, LPP e parashikon që të jepë një standard internacional AK të kërkojë standard mirëpo të kërkojë edhe standarde të tjera. Në deklarinë Autoriteti Kontraktues i cili thekson që bëhet fjalë për mirëmbajtjen kjo është në kundërshtim me Titullin e aktivitetit, “ Implementimi i sistemit elektrik të automjeteve me pajisje GPS” ndërkajë kërkohet Mirëmbajtja e pajisjeve” andaj rekomandimi i ynë për këtë AP është që të rishikohen termat e referencës dhe nëse Autoriteti Kontraktues dëshiron të ketë kompetencën të hapur atëherë të ju ofroj mundësinë të gjithë EO të aplikojnë, dhe nëse duhet zëvendësohen këto pajisje ato të zëvendësohen pa një kosto shtesë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë që të aprovohet ankesa e jonë si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Kërkojmë që të hudhet poshtë ankesa e OE si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertëve të OSHP-së, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shprehjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor sqaron se duke u bazuar në dosjen e tenderit, specifikave teknike si : “Vërejtje: Komuna posedon pajisjet e lartë cekura, dhe nuk ka ndërmend që të bëjë ndryshime të pajisjeve, andaj OE fitues duhet të mirëmbajë pajisjet ekzistuese. OE fitues duhet të përfshijë sim kartelën me GPRS në çmim.” Bazuar edhe në pyetjet dhe përgjigjet e adresuara për këtë aktivitet të prokurimit. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues teknik konstaton se AK ka bërë shkelje të nenit 28 duke përgatitur Specifika të cilat kufizojnë tregun pavarësisht se në stok ka produkte të caktuara, andaj konsideroj se nëse AK vazhdon me procedure të hapur të prokurimit do të duhet të u japë mundësi të gjithë OE të aplikojnë për një Projekt të tillë.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues teknik konstaton se nëse AK dëshiron qe te ketë treg te hapur dhe oferta për këtë produkte atëherë AK mund te kërkoj nga OE qe ne ofertat e tyre te ofrojnë produktet e tyre te cilat plotësojnë specifika minimale te kërkuara nga AK-ja dhe te mund te zëvendësoj te gjitha pajisjet me produktet e tyre pa Kosto Shtese ose nëse oferton me produktet e njëjtat te vazhdoj mirëmbajtjen e tyre.

Sa i përket pretendimit te ankuesit se Kërkesa qe produkti te ketë standardin: GLONASS, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues teknik konstaton se AK mund te kërkoj Standardë ne mënyrë qe te kërkoj edhe kualitet me te mire te produktit pa cenuar Tregun, kjo nënkupton se AK mund te kërkoj një Standard te Tille si GLONASS mirëpo konsiderojmë se duhet te shtohet edhe një fjali e cila potencon se OE mund te ofrojnë edhe Standarde Ekuivalente, pasi kërkimi i vetëm një standardi kufizon tregun.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetem Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna Prishtinë,–Prishtinë,
- 1x1 OE–"Proinfo ICT"SH.P.K.- Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.